

KUJDES!

- Mos harroni të kodoni grupin (A ose B) në fletë-përgjigjen e provimit. **Fletë-përgjigjet me grupin e pakoduar nuk vlerësohen.**
- Çdo pyetje ka vetëm një përgjigje të saktë. Nëse një pyetjeje i jepni dy përgjigje atëherë ajo pyetje do të vlerësohet si e gabuar.
- Përgjigja do të kodohet me laps. Në të kundërt kompjuteri nuk do ta lexojë.
- Përgjigjen e pyetjes do ta kodoni vetëm brenda rrethit siç është vepruar në shembullin e poshtëshënuar

Saktë A B C D

Gabim A B C D

- Bëni kujdes për të mos dalë jashtë rrethit kur të kodoni përgjigjen.
- Mos bëni asnjë veprim mbi fletë përgjigjen e provimit si shkarravitje, rrudhosje etj.
- Mos iu përgjigjini pyetjeve për të cilat nuk jeni të sigurtë. **Kujdes! 3 përgjigje gabim fshijnë një të saktë.**
- Mos qëndroni shumë tek pyetjet që nuk zgjidhni dot, sepse koha mund të mos ju mjaftojë për t'iu përgjigjur pyetjeve të tjera.
- Koha e provimit është **150 minuta**. Shfrytëzoni deri në fund kohën e provimit. Në qoftë se ju tepron kohë, bëjini dhe një kontroll testit.
- Përgjigjet e pyetjeve që ndodhen në këtë libërth, do të kodohen në fletë-përgjigje në pjesën ku shkruan “PERGJIGJET”.
- Në provim **ndalohet** mbajtja ose përdorimi i celularit dhe makinës llogaritëse.
- Rezultati i provimit bazohet vetëm në fletë-përgjigje.
- Libërthi i pyetjeve dorëzohet bashkë me fletë-përgjigjen dhe nuk kërkohet marrja e tij.

Suksese!

1.

Thjeshto shprehjen $\frac{(3^2 \times 3^3)^{-1}}{3^{-2} \times 3^5}$.

- A) 3^5 B) 3^8
 C) 3^{-5} D) 3^{-8}

2.

Kemi listën e numrave.

$-8, \frac{5}{6}, \sqrt{10}, \sqrt{16}, 2\frac{9}{10}, 85, \sqrt{17}, 5\pi, \frac{\sqrt{27}}{\sqrt{3}}$

Sa prej tyre janë numra racional?

- A) 3 B) 4
 C) 5 D) 6

3.

Shprehni v në varësi të ndyshoreve të tjera në formulën

$$a = \frac{v^2 - u^2}{2s}$$

- A) $v = \frac{u^2 + 2sa}{u}$ B) $v = u^2 + 2sa$
 C) $v = \sqrt{u^2 + 2sa}$ D) $v = \sqrt{u + 2sa}$

4.

Fatjoni mendon një numër pozitiv, n , shton 4 dhe më pas e ngre në katror. Më pas ai e shumëzon atë numër me 2. Nëse numri me të cilin Fatjoni përfton është 162, gjeni numrin që kishte menduar Fatjoni.

- A) 3 B) 4
 C) 5 D) 6

5.

Një stacion i roje bregdetare C zbulon varkën A 15 km larg me kursin 150° dhe varkën B 20 km larg me kursin 240° . Gjeni distancën midis dy varkave.

- A) 25 km B) 28 km
C) 31 km D) 34 km

6.

Një kuboid ka gjatësi brinjësh 4 cm, 6 cm dhe 8 cm. Sa plane të simetrisë ka kuboidi?

- A) 3 B) 4
C) 5 D) 6

7.

Masa e një qelize të bardhë të gjakut është $2,7 \times 10^{-13}$ gram. Sa është ajo në kilogram? Jepni përgjigjen tuaj në shkrim shkencor.

- A) $2,7 \times 10^{-16}$ B) $2,7 \times 10^{-10}$
C) $2,7 \times 10^{13}$ D) $2,7 \times 10^{10}$

8.

Një numër i rumbullakosur në 100-shen më të afërt është 2600. Cili nga këta numra nuk mund të jetë?

- A) 2560 B) 2650
C) 2550 D) 2601

9.

Në tabelë tregohet koha që i duhet një grupi prej 40 nxënësish për të zgjidhur një fjalëkryq.

Koha (x min)	Denduria
$0 \leq x < 10$	8
$10 \leq x < 20$	11
$20 \leq x < 30$	15
$30 \leq x < 40$	6

Sa është mesatarja e kohës?

- A) 19.55 B) 19.65
C) 19.75 D) 19.80

10.

Një cilindër metalik ka një lartësi prej 10 cm dhe një rreze prej 5 cm. Gjeni vëllimin e cilindrit. (Take $\pi = 3.1$)

- A) 760 cm^3 B) 765 cm^3
C) 770 cm^3 D) 775 cm^3

11.

Rrezja e një keku rrethor me mollë është 12 cm. Pasi është ngrënë tre e katërta, lihet një e katërta siç tregohet. Sa është perimetri i pjesës së mbetur të kekut me numrin e plotë më të afërt? (Take $\pi = 3.14$)



12 cm

- A) 40 cm B) 41 cm
C) 42 cm D) 43 cm

12.

Gjej
$$\frac{\left(2\frac{1}{2} - 1\frac{1}{3}\right) \times 3\frac{1}{2}}{\frac{5}{6} - \frac{2}{3} \div 1\frac{1}{2}}$$

- A) $13\frac{1}{2}$ B) $10\frac{1}{2}$
C) $10\frac{1}{3}$ D) $13\frac{1}{3}$

13.

Një ndërtues dëshiron të suvatojë një mur.

Muri ka përmasa $7\frac{1}{2}$ m me $4\frac{2}{5}$ m.

Çdo thes suva do të mbulojë 11 m^2 dhe do të kushtojë 8,20 dollarë. Sa do t'i kushtojë ndërtuesit suvatimi i murit?

- A) 18.8 B) 20.2
C) 22.4 D) 24.6

14.

Cili është ekuacioni i drejtëzës paralele me $y = 2x - 3$ që pret boshtin- y në pikën $(0; 7)$.

- A) $2x - 7$ B) $2x + 7$
C) $7x - 2$ D) $7x + 2$

15.

Zgjidhja e mosbarazimit

$7(3x + 12) - 4(2x - 5) > -52$ është:

- A) $[12; \infty[$ B) $[-12; \infty[$
C) $]12; \infty[$ D) $] -12; \infty[$

16.


Jepet sistemi $\begin{cases} 2x + 3y = 9 \\ 4x - 2y = 10 \end{cases}$.

Sa është vlera e $x + y$?

- A) 3 B) 4
C) 5 D) 6

17.


Në figurë, ABF është një vijë e drejtë. Gjeni vlerën këndit y .



- A) 134°
- B) 136°
- C) 138°
- D) 140°

18.

Në diagram, $ABCDEFGHIJKL$ është një dymbëdhjetëkëndësh i rregullt dhe $ABPQRS$ është një gjashtëkëndësh i rregullt.



Cila është masa e këndit BCP ?

- A) 65°
- B) 70°
- C) 75°
- D) 80°


19.

Këndet në një katërkëndësh janë në raportin $17 : 21 : 25 : 9$. Sa është masa e këndit më të madh?

- A) 85°
- B) 105°
- C) 125°
- D) 135°

20.

$ABCD$ dhe $EFGH$ janë drejtëza paralele. $QFBP$ dhe $QGCR$ janë drejtëza. Gjeni $x + y$.



- A) 163°
- B) 166°
- C) 169°
- D) 172°


21.

Klaudia udhëton me 45 km/h për 130 minuta. Sa kohë, do t'i duhej asaj për të njëjtën distancë nëse do të udhëtonte me një shpejtësi prej 65 km/h?

- A) 1.2 orë
- B) 1.5 orë
- C) 1.8 orë
- D) 2 orë

22.

Grafikët rrethorë tregojnë shpërndarjen e llojeve të transportit të përdorura nga dy grupe nxënësish për të shkuar në shkollë çdo ditë. Në shkollën A janë 120 nxënës dhe në shkollën B 150 nxënës.



Sa më shumë nxënës udhëtojnë me autobus në shkollën A sesa në shkollën B?

- A) 8
- B) 10
- C) 12
- D) 16

23.


y është në përpjesëtim të drejtë me x . Tabela tregon disa vlera të x dhe y . Gjeni $a + b$.

x	20	50	b
y	30	a	105

- A) 135
- B) 140
- C) 145
- D) 160

24.

Për një udhëtim me taksi, kostoja prej \$C, pas x km është paraqitur në këtë grafik.



Cili është gradienti (koeficienti këndor) i grafikut?

- A) 2
- B) 2.5
- C) 3
- D) 3.5

25.

Ekuacioni i drejtëzës është $y + \frac{1}{2}x = 1$.

Në cilën pikë drejtëza pret boshtin- y ?

- A) (1; 0)
- B) (0; 1)
- C) (0; -1)
- D) (-1; 0)

26.


Një figurë A ka një perimetër prej 24 cm. Figura B është zmadhim i figurës A me shkallë zmadhimi 3. Sa është perimetri i figurës B?

- A) 66 cm
- B) 68 cm
- C) 70 cm
- D) 72 cm

27.

Figura A është paraqitur në rrjetin koordinativ.

Sa do të jetë koordinata e pikës P pas zhvendosjes me vektor $\begin{pmatrix} 0 \\ -4 \end{pmatrix}$?



- A) (1; 0)
- B) (0; 1)
- C) (1; -1)
- D) (-1; 1)

28.

Çmimi fillestar i një shtëpie ulet me 10%. Ky çmim i ri më pas rritet me 10%. Gjeni çmimin e shtëpisë tani si përqindje e çmimit origjinal.

- A) 90%
- B) 93%
- C) 96%
- D) 99%

29.

Norma e interesit në një bankë është 4% interes i thjeshtë në vit. Deana ka 2000 dollarë. Sa kohë do t'i duhet t'i mbajë paratë e saj në bankë që të fitojë 400 dollarë në interes?

- A) 3 vite
- B) 5 vite
- C) 7 vite
- D) 9 vite

30.

Dy shigjeta rrotulluese me 4 anë, të dyja me numra nga 1 në 4, janë rrotulluar. Plotësoni tabelën me dy drejtime për të treguar shumën e pikëve të rezultateve të mundshme.


		Shigjeta 2			
		1	2	3	4
Shigjeta 1	1	2	3	4	
	2			5	
	3		5		7
	4	5			8

Sa është probabiliteti që shumta e pikëve të jetë një numër i thjeshtë?

- A) $\frac{5}{16}$
- B) $\frac{7}{16}$
- C) $\frac{9}{16}$
- D) $\frac{11}{16}$

31.


Cila figurë duhet në vend të pikëpyetjes?



- A) B) C) D)

32.


Sa kube ka në figurë?



- A) 53 B) 54
C) 55 D) 56

33.




Cila figurë duhet në vend të pikëpyetjes?



- A) B) C) D)

34.

Cila figurë duhet në vend të pikëpyetjes?



- A) $\Delta\Delta\circ$ B) $\Delta\circ$
C) $\square\square$ D) $\Delta\Delta$

35.

Sa është vlera e c sipas tabelave?

+	a	b	c	×	a	b	c
a			10	a		28	
b				b			12

- A) 3 B) 4
C) 5 D) 6

36.

Cecila fjalë përfaqësohet vetëm me një nga numrat.

$$\left. \begin{array}{l} \text{DOST} \\ \text{PAST} \\ \text{KOST} \\ \text{HOST} \\ \text{KAST} \end{array} \right\} \begin{array}{l} 5134 \\ 7134 \\ 5234 \\ 8134 \\ 9234 \end{array} \Rightarrow \text{TOAST} = ?$$

- A) 42134 B) 41234
C) 41243 D) 41324

37.

Sipas veprimeve të dhëna sa është vlera e pikëpyetjes?


- I. $a \bullet b = a^b + b^a$
II. $4 \bullet 3 = ?$

- A) 95 B) 105
C) 135 D) 145


38.

Cila figurë duhet në vend të pikëpyetjes?


I.




II.




A)




B)



C)









D)







39.

Cila figurë duhet në vend të pikëpyetjes?



40.

Cila figurë duhet në vend të pikëpyetjes?



41.

Cili numër duhet në vend të pikëpyetjes?

21 30 41 54 69 ?

A) 82




B) 84

C) 86

D) 87

42.

Cilat numra duhen në vend të pikëpyetjeve?



A) 2; 1; 2; 3






B) 2; 2; 3; 1

C) 3; 2; 1; 2

D) 3; 1; 2; 2



43.

Cila figurë duhet në vend të pikëpyetjes?



44.

Cili numër duhet në vend të pikëpyetjes?



- A) 653 B) 1440
C) 6350 D) 6530

45.

Cili numër duhet në vend të pikëpyetjes?

$$\frac{K}{LM} + \frac{K}{LM} \quad \frac{K}{L} - \frac{M}{L} \quad \Rightarrow \quad L + K = ?$$

- A) 8 B) 9
C) 11 D) 13

46.

Cili numër duhet në vend të pikëpyetjes ?

●	1	2	3
4	7	5	3
5	2	1	4
6	6	9	8


▲	5	7	3
2	3	5	1
1	7	9	6
4	2	4	8

⇒ ((1 ● 5) ▲ 7) ● (4 ▲ 5) = ?

- A) 1 B) 2
C) 5 D) 7

47.

Cila figurë duhet në vend të pikëpyetjes?




⇒ x + y = ?

- A) 14 B) 16
C) 22 D) 42

48.

Cili numër duhet në vend të pikëpyetjes?




$\Rightarrow C - A \times B = ?$

- A) 0
- B) 1
- C) 50
- D) 75

49.


Cili numër duhet në vend të pikëpyetjes?



- A) 2
- B) 4
- C) 6
- D) 8

50.

Cila figurë duhet në vend të pikëpyetjes?



- A)
- B)
- C)
- D)

51.

Shoqërohen me lahutë dhe quhen “këngë lahute”:

- A) Mitet shqiptare
- B) Lirika popullore
- C) Eposi i kreshnikëve
- D) Përrallat

52.

Veçoritë e përbashkëta të tregimit me përrallën i gjejmë në pjesën:

- A) “Vajtimi i Ajkunës”
- B) “Djali, shkabonja dhe e Bukura e Dheut”
- C) “Rozafati”
- D) “Rinë Katerinëza”

53.

Vlerësohet si poeti i parë modern shqiptar që zhvilloi në poezinë shqipe traditën e simbolistëve francezë:

- A) Ismail Kadare
- B) Lasgush Poradeci
- C) Fatos Arapi
- D) Dritëro Agolli

54.

Tragjedia “*Antigona*” është shkruar nga:

- A) Eskili
- B) Sofokliu
- C) Homeri
- D) Shekspiri

55.

Vepra “*Bagëti e Bujqësia*” e Naim Frashërit është e afërt me:

- A) Poemën epike
- B) Poemën didaktike
- C) Odenë
- D) Idilin

56.

Ironia therëse dhe e hidhur, kur shpreh urrejtje dhe përbuzje të thellë dhe merr karakter sulmues, quhet:

- A) simbol
- B) sarkazëm
- C) similitudë
- D) paralelizmit figurativ

57.

Trajtoi gjerësisht temën e mjerimit në veprat e tij:

- A) Mitrush Kuteli
- B) Millosh Gjergj Nikolla
- C) Martin Camaj
- D) Anton Pashku

58.

Ka në thelb rrëfimin e ngjarjeve dhe karakteristikë mbizotëruese e saj është objektiviteti:

- A) Epika
- B) Dramatika
- C) Lirika
- D) Soneti

59.

Janë shkruar nga Ernest Koliqi veprat:

- A) “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo”, “Arka e djallit”, “Njeriu me top”
- B) “Tregtar flamujsh”, “Pasqyrat e Narcizit”, “Kumbulla përtej murit”
- C) “Ruga e Golgotës”, “Stina e stinëve”, “Odin Mondvalsen”
- D) “Kështjella”, “Pallati i ëndrrave”, “Prilli i thyer”

60.

Bashkëvendosja e dukurive të natyrës me ngjarje të jetës njerëzore që kanë lidhje ngjashmërie, lidhet me figurën letrare të:

- A) epitetit
- B) metaforës
- C) paralelizmit figurativ
- D) simbolit

61.

Kemi mbiemër të emërzuar në fjalinë:

- A) Sa të mundemi të bëjmë mirë.
- B) E mira shpërblehet gjithmonë!
- C) Ai bëri zgjedhjen më të mirë.
- D) Të gjithë e duan mirësinë.

62.

Përcaktoni alternativën që ka vetëm folje të parregullta:

- A) ha, pi, rri, hap, mbyll
- B) leh, mjaullin, cicërin, vetëtin
- C) fryn, kishte rënë, gjëmon, kam vizatuar
- D) ha, rri, jap, shoh, bie

63.

Dalloni në cilën fjali, kemi parafjalë të rasës gjinore:

- A) I arritëm këto rezultate nga të dhënat e reja.
- B) Sipas të dhënave të fundit ju dolët të parët e konkursit.
- C) Ky ishte rezultati i të dhënave të fundit.
- D) Në sajë të të dhënave që na dhe ti, arritëm këtu.

64.

Cila fjali është njëkryegjymtyrëshe foljore me vetë të përgjithësuar:

- A) Ishim të gjithë në një mendje.
- B) Fëmijët i quajmë lulja e jetës.
- C) Mos i shiko gunën, por punën.
- D) Për Skëndërbeun tregojnë shumë legjenda.

65.

Dalloni fjalët e shkruara saktë:

- A) higjenë, standarte, agjensi
- B) ambicje, ambjent, dialekt
- C) ambient, proces, certifikatë
- D) çertifikatë, proçes, pjanist

66.

Ka folje kalimtare në fjalinë:

- A) Kjo gjë dihet nga të gjithë.
- B) Papritur e humba nga sytë, por e rigjeta sakaq.
- C) Atë ditë gjëmonte si asnjëherë tjetër.
- D) Macja mjaullinte mbi çatinë e shtëpisë.

67.

Dalloni fjalinë dëshirore me folje në mënyrën dëshirore:

- A) Paskësh shkruar një vepër shumë të bukur!
- B) Të shkojmë herë tjetër më mirë!
- C) Mbretëroftë e drejta në atdheun tonë!
- D) Qenkësh vërtet këngëtare e mrekullueshme ajo vajzë!

68.

Dalloni përdorimin e saktë të apostrofit:

- A) M'a jep dhe mua librin që t'a lexoj dhe unë.
- B) Të thashë që do të mi jepnin të gjitha pikët.
- C) T'i tregova të gjitha për sa më pyete.
- D) Ç'tu desh që të shkoje dhe ti me ta?

69.

Në cilën prej alternativave kemi fjali me pjesë të nënrenditur ffilluese kundrinore:

- A) Ku ishe dje, se nuk të pashë në shkollë.
- B) Asnjëherë nuk e kupton ku e ka gabimin.
- C) Fëmija u fut papritur në sallën ku rrinin të ftuarit.
- D) U afruan atje ku do të mbillnin pemën e parë.

70.

Cila prej fjalive ka skemë të nënrenditjes së varguar:

- A) Pasi kuptoi se të gjithë kishin vëmendjen, heshti një çast që iu duk se zgjati një jetë.
- B) Mjegulla që kishte mbuluar fushën, tregonte se do të prishej koha.
- C) Me klasën shkuam në kinema, sepse shfaqej një film që kishte dalë së fundmi.
- D) Në dhomë hyri Ina dhe m'u duk e rritur, sepse e shihja për herë të parë pas kaq vitesh.